



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve
dhe Emertimeve



Fushe-Arrez, me 24.12.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 41, datë 12/12/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin "Mbi Trajtimin me Bursë të nxënësve të Shkollave të Mesme Profesionale për vitin shkollor 2025-2026"

Analiza ligjore Është në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) " Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", shkresës me nr. 973/1prot. datë 29.10.2025 të Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore, mbi "Plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin klasën e 10-të në shkollat e mesme të arsimit profesional publik për vitin shkollor 2025-2026.

Situata aktuale dhe financiare e funksionit: Nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë sipas kriterëve të përcaktuara në VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar me (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike".

Këtë vit kanë aplikuar 3 (tre) nxënës të vitit të parë në shkollat e mesme profesionale që janë me pasaportizim në Bashkinë Fushë-Arrez, prej të cilëve përfitojnë vetëm 3 (tre) nxënës.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Arsimit dhe Kultures ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Arsimit dhe Kultures për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha nxenesve e Bashkise dhe te ardhmen e femijeve dhe te rinjve qe jetojne ne territorin e Bashkise Fushe Arrez.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk eshte objekt konsultimi publik.

Komisioni i Komisioni i Arsimit Kultures, Sportit Rinise, Trashigimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve, i mbledhur me datën 26/08/2025, shqyrtoi projekt vendimin nr. 41, datë 12/12/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin "Mbi Trajtimin me Bursë të nxënësve të Shkollave të Mesme Profesionale për vitin shkollor 2025-2026" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Benjano Marku Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA FUSHE-ARREZ

KESHILLI BASHKIAK

Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve

Nr. 4037 Prot.

Fushe-Arrez, me 24.12.2025

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

Relacion i Komisionit të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve mbi shqyrtimin e projektvendimit për PROJEKTIN E SHPËRNDARJES SË BURSAVE PËR NXËNËSIT E KLASËS SË DHJETË TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mbledh sot, me 24.12.2025, Komisioni i të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve , dhe u shqyrtua projektvendimi për shpërndarje të bursave për nxënës të klasës së dhjetë të shkollave të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026.

Sekretare e Keshillit Bashkiak, Naze Selimaj në mungesë të përfaqësuesit të arsimit shpjegoi anetaret e komisionit lidhur me kriteret e përfitimit dhe me dokumentacionin e mbledhur për çdo nxënës nga Specialisti për Arsimin në bashki, Z. Altin Engjelli.

Ajo tha se Zyra janë bazuar në VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresës me nr. 973/1prot. datë 29.10.2025 të Ministrisë Ekonomisë Kultures dhe Inovacionit-Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore, mbi “Plani i shpërndarjes së bursave për nxënës të ndjekin klasën e 10-të në shkollat e mesme të arsimit profesional publik për vitin shkollor 2025-2026.

Njëkohësisht në propozimin për akordimin e bursave është mbajtur në konsideratë gjendja ekonomike e familjeve të nxënësve kërkues të bursave, shumica, e të cilave janë familje me të ardhura të kufizuara (ndihmë ekonomike)

Këta nxënës nuk kanë shkollë të mesme Profesionale në vendbanim dhe shkollat ku mësojnë i kanë më shumë se 5 km larg vendbanimit.

Për nxënës të shkollave profesionale që propozohen për të përfituar bursë është mbajtur në konsideratë kriteri ekonomik i përcaktuar në kriterin nr. 2.1 pika a) sipas pasqyrës nr. 1 bashkëlidhur me VKM e sipërpërmendur si dhe Kriteri 2.4 pika a) i degeve paresore të zhvillimit ekonomik të vendit: “nxënës të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mësimore bujqësi, veterinar, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit”.

Sa më sipër kërkohet miratim i vendimit për shpërndarjen e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar sipas projektit të paraqitur duke kontribuar në rritjen e nivelit të arsimit të brezit të ri si dhe në lehtësimin e ngarkesës financiare të familjeve për shkollimin e fëmijëve.

Gjithsej aplikime janë 3 nxenes që vazhdojnë vitin e parë të shkollave të mesme profesionale.

Anetaret e komisionit në këtë mbledhje ishin dakord me gjithçka kishte projektvendimi dhe me shumicë votash vendosen ta dergojnë projektin për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e datës 26.12.2025.

PER KOMISIONIN

Franc DODA

Besiana Marku




Tereza Dema
Jemoz